



# Rregullorja e Kodit të Sjelljes

Aprovuar nga Këshilli i Menaxhimit- Mars 2023

Informacion i përgjithshëm	
Aprovuar nga	Këshilli i Menaxhimit Bordi Ekzekutiv
Aprovuar më datë	29 Mars 2023
Versioni	1
I detyrueshëm për	<ol style="list-style-type: none"><li>Të gjitha shoqatat antare të SOS Fshatrat e Fëmijëve Ndërkombëtarë (anëtarët e zakonshëm), duke përfshirë edhe entitetet e lidhura me to; antarët e organizmave qeverisës të tyre; si dhe të gjithë punonjësit dhe personat e tjerë që punojnë për ta, ose në emër të tyre.</li><li>SOS Fshatrat e Fëmijëve Ndërkombëtarë, duke përfshirë edhe entitetet e lidhura me të; antarët e organizmave qeverisës të tyre; si dhe të gjithë punonjësit dhe personat e tjerë që punojnë për ta, ose në emër të tyre.</li><li>Ky dokument është i vlefshëm që nga data e treguar. Zbatueshmëria e tij ligjore duhet siguruar në nivel kombëtar duke respektuar legjislacionin lokal.</li></ol>
Bazuar në	Politika e Njërëzve dhe Kulturës (për t'u konfirmuar)
Zëvendëson	Kodin Aktual të Sjelljes
Dokumente që lidhen me të	Link -u me hapsirën e punës <a href="https://sosc.v.sharepoint.com/sites/WS_002396/Shared%20Documents/SFP3.3%20Values-based%20initiatives/Review%20of%20Code%20of%20Conduct">https://sosc.v.sharepoint.com/sites/WS_002396/Shared%20Documents/SFP3.3%20Values-based%20initiatives/Review%20of%20Code%20of%20Conduct</a>
Rishikimi i ardhshëm	2026
Pronësia e dokumentit	Departamenti i Burimeve Njerëzore-HROD
Historia e Rishikimeve	Seksioni Amenduar më datë Komente



## Kuadri i Politikave

Kuadri i Politikave të SOS Fshatrat e Fëmijëve Ndërkombëtarë, aprovuar nga Asambleja e Përgjithshme në Qershor 2021, ka tre nivele të detyrueshme (nivele të themelor, atë të politikave dhe rregulloret), si dhe një nivel jo-të detyrueshëm (udhëzuesit për përdoruesit).

FOUNDATION	POLICY	REGULATION	USER GUIDE
Principal binding documents of our federation that form the basis of our work	Binding documents with high-level obligations, anchored in a foundation	Binding documents with detailed implementation obligations, anchored in a policy or foundation	Non-binding guidance material to support in implementation of foundations, policies & regulations
Approved by General Assembly	Approved by General Assembly	Approved by the MCO and the Executive Board	Approved by Executive Board

THEMELORE	POLITIKAT	RREGULLORET	UDHËZUESIT PËR PËRDORUESIT
Dokumentat kryesore të detyrueshme të federatës sonë, të cilat përbëjnë bazën e punës tonë	Dokumenta të detyrueshme me obligime të nivelit të lartë, të bashkëngjitura në një dokument themelor	Dokumenta të detyrueshme, me obligime të detajuara zbatuese, të përfshira në një politike apo në një dokument themelor	Dokument udhëzues jo i detyrueshëm në mbështetje të zbatimit të dokumentave themelore, politikave & rregulloreve
Aprovuar nga Asambleja e Përgjithshme	Aprovuar nga Asambleja e Përgjithshme	Aprovuar nga Këshilli i Manaxhimit dhe Bordi Ekzekutiv	Aprovuar nga Bordi Ekzekutiv



# Përmbajtja

Qëllimi .....	4
Fusha e Veprimtarisë që mbulon Kodi i Sjelljes(B) .....	4
Qasja ndaj Kodit të Sjelljes – Të Vësh në Jetë Vlerat Tona (B) .....	4
Formati i Kodit të Sjelljes (B).....	5
Aplikimi i Kodit të Sjelljes (B) .....	6
Angazhimi i Organizatës (B) .....	6
Kodi i Sjelljes.....	7
Parimet themelore (B) .....	7
Pritshmëritë e sjelljes – nga individët dhe personat e tjerë (B) .....	8
Angazhimi ndaj Kodit të Sjelljes (B).....	13

# Qëllimi

Ne si SOS Fshatrat e Fëmijëve, e njohim dhe kuptojmë faktin që si një Federatë e angazhuar në mbrojtjen dhe mirëqënien e fëmijëve, të rinjve dhe komuniteteve, dhe e cila operon në shumë vende të botës, ne kemi përgjegjësinë për të punuar në mënyrë të tillë që të mbështeten dhe mbrohen si personat të cilëve ne u shërbejmë, ashtu edhe personat të cilët punojnë me ne dhe për ne. Ne e njohim dhe kuptojmë faktin që ne na janë besuar fonde dhe burime nga sponsor dhe donatorë, dhe që ne duhet të jemi në gjendje t'u demonstrojmë atyre që na mbështesin, që besimi që na kanë dhënë do të jetë plotësisht i justifikuar.

Kodi jonë i Sjelljes ka rëndësi themelore për përcaktimin e pritshmërive të ndara në lidhje me sjelljet e pranueshme. Qëllimi ynë është që të promovojmë një mjedis të sigurtë, ku secili të ketë mundësinë që të arrijë dhe të shprehë potencialin e plotë të tij/saj në rolet që kanë, ku asetet tona të manaxhohen dhe përdoren në mënyrë të zgjuar dhe ku të promovohen interesat më të mira të fëmijëve dhe të rinjve për të cilët ne kujdesemi. Përveç kësaj, Kodi i Sjelljes synon të mbrojë sigurinë dhe dinjitetin e pjesëmarrësve të rritur nëpër programe, si dhe të antarëve të komuniteteve në të cilat ne punojmë.

## Fusha e Veprimtarisë që mbulon Kodi i Sjelljes (B)

Kodi i Sjelljes aplikohet për të gjithë ata të cilët punojnë me ose në emër të SOS Fshatrat e Fëmijëve, në çfarëdo roli apo pozicioni, ashtu si dhe në çdo nivel dhe në çdo kohë. Kjo përfshin antarët e bordit, (duke përfshirë këtu edhe presidentin, zëvendës-presidentin dhe drejtorët nacionalë), stafin e punësuar me pagesë, vullnetarët si dhe personat e tjerë që kanë pozicione honorifike, konsulentët, stazhierët, partnerët ku përfshihen edhe donatorët, vizitorët, shitësit dhe furnitorët.

Ne e njohim dhe kuptojmë që sjella e përsosur që punojnë me ne, si në kohën gjatë së cilës ata janë në punë, ashtu dhe gjatë jetës private të tyre, reflekton dhe ka të bëjë me imazhin e Federatës.

## Qasja ndaj Kodit të Sjelljes – Të Vësh në Jetë Vlerat Tona (B)

Kodi i ri i Sjelljes, është përgatitur duke u bazuar në kuadrin e kompetencave bazuar – tek- vlerat, ku përfshihen vlerat e federatës tonë, kompetencat themelore bazuar-tek-vlerat si dhe tek kompetencat e lidership-it bazuar-tek –vlerat.

**Promovimi i sjelljes së bazuar-tek-vlerat**, përbën një komponent gjithëpërfshirës në drejtim të objektivave tona strategjike për vitin 2030 në lidhje me ruajtjen. Vlerat tona të **Angazhimit, Besimit, Kurajos dhe Llogaridhënies**<sup>1</sup>, së bashku me **parimet themelore** që lidhen me to, përcaktojnë ato gjëra që janë të rëndësishme për ne si Federatë si dhe llojin e organizatës që ne jemi/synojmë të bëhemi.

Katër vlerat tona janë përpunuar në mënyrë të metëjshme në kuadrin tonë të kompetencave<sup>2</sup> të cilat përcaktojnë nëntë kompetencat për të gjithë ata që punojnë me/për SOS Fshatrat e Fëmijëve.

<sup>1</sup> Ashtu siç përcaktohet tek "Kush jemi ne": [Rreth nesh – Vlerat tona\(sharepoint.com\)](#)

<sup>2</sup> Shikoni kuadrin e kompetencave bazuar-tek-vlerat "Të Vësh në Jetë Vlerat Tona": [Mirësevini në Hapsirën e Bashkëpunimit të Kompetencave Bazuar -tek-Vlerat\(sharepoint.com\)](#)

Kompetencat themelore janë Mirësia, Të Mësuarit e Vazhdueshëm, Aftësia për Përfshirje, Iniciativa dhe Orientimi drejt Rezultatit, plus edhe katër kompetenca specifike për personat që mbulojnë pozicione lidhshpë: Modeli i Roleve, Bashkëpunimi, Fuqizimi dhe të Menduarit Strategjik.

Pavarësisht se kompetencat mund të shprehen si veprime dhe sjellje, ato janë tipikisht më të përgjithësuara në natyrë dhe shprehen nëpërmjet karakteristikave, aftësive dhe qasjeve. Ashtu si kompetencat lidhen me vlerat e organizatës, Kodi i Sjelljes lidh sjelljet me kompetencat dhe në këtë mënyrë, lidhet edhe me vlerat e Federatës.

Nëpërmjet përcaktimit të pritshmërive në lidhje me sjelljet, Kodi i Sjelljes mbështet të kuptuarit e asaj që kur një sjellje e caktuar nuk është e pranueshme ashtu si dhe të rasteve kur do të nevojitej një veprim shtesë për ta adresuar një sjellje të tillë, për të parandaluar që ajo të ri-shfaqej përsëri, si dhe për t'u ofruar mbështetje personave të prekur nga kjo sjellje.

Kjo përfshin promovimin e një kulture ku njerëzit të ndihen të lirë dhe të jenë në gjendje të flasin në lidhje me atë që po ndodh, si dhe të jenë përgjegjës dhe të japin llogari ata vetë, por edhe personat të cilët punojnë me dhe për Federatën.

#### **Lidhja ndërmjet Kodit të Sjelljes dhe politikave, rregulloreve dhe udhëzuesve të tjerë**

Ndërkohë që Kodi i Sjelljes përcakton pritshmëritë, bazuar tek vlerat tona (dhe kuadrin e kompetencave), ai nuk është një dokument i vetëm, pa lidhje me të tjerë. Ai lidhet me rregullore, politika dhe praktika të tjera të rëndësishme, të cilat përfshijnë:

- "Kush Jemi Ne" – Deklarata e Misionit të SOS Fshatrat e Fëmijëve
- Premtimin e Kujdesit të SOS
- Politikën për Mbrojtjen e Fëmijëve
- Procedurat për Raportimin dhe Reagimin lidhur me Mbrojtjen e Fëmijëve
- Rregulloren për Sjelljet e Gabuara Seksuale
- Politikën për barazinë Gjinore
- Udhëzuesin Anti-Mashtrim dhe Anti-Korrupsion
- Standardet e cilësisë për Manaxhimin dhe Llogaridhënien e Mirë
- Rregulloren për manaxhimin e incidenteve lidhur me sjelljet e gabuara
- Rregulloren për investigimin e sjelljeve të gabuara

## **Formati i Kodit të Sjelljes (B)**

Kodi i Sjelljes është konceptuar dhe përgatitur duke u bazuar tek kuadri i kompetencave bazuar-tek-vlerat. Sjelljet e pritshme përbëjnë evidenca të sjelljeve tona. Ne rastet kur ekziston ndonjë dyshim në lidhje me sjelljen e pritshme dhe të kërkuar, atëherë u duhet referuar **parimeve themelore** për udhëzime të mëtejshme (të përmbledhura në vetë Kodin, Pjesa 2).

## **Aplikimi i Kodit të Sjelljes (B)**

Çdo shkelje e Kodit të Sjelljes do të trajtohet me seriozitet dhe, atëherë kur do të ishte e nevojshme, në përputhje me politikën dhe rregulloret e SOS si dhe me aktet nën-ligjore, ashtu si dhe me ligjet përkatëse ndërkombëtare dhe kombëtare, do të ndërmerren veprimet e duhura për ta adresuar situatën si në lidhje me nevojat e personave të prekur, ashtu dhe të personave përgjegjës. Është gjithashtu po kaq e rëndësishme që të nxirren mësimet përkatëse, në mënyrë që jo vetëm situata të tilla të mund të parandaloheshin në të ardhmen, por edhe të rishikoheshin formatet e incidenteve të ruajtjes, të cilat janë

pjesë përbërëse e implementimit të Kodit të Sjelljes.

Kodi i Sjelljes mund të rishikohet çdo tre vjet dhe gjithësesi në jo më shumë se çdo pesë vjet, me qëllimin për të vlerësuar efektivitetin e tij si dhe për të matur shkallën e implementimit të tij në nivelin praktik.

## Angazhimi i Organizatës (B)

Pavarësisht se personat individë kanë përgjegjësinë për ta mbështetur Kodin e Sjelljes, ne e njohim dhe kuptojmë faktin që si Federatë, ne kemi përgjegjësinë për të siguruar që këtyre personave t'u jepet mbështetja dhe udhëheqja e nevojshme, në mënyrë që ata të jenë në gjendje të plotësojnë angazhimet e tyre në kuadrin e Kodit të Sjelljes.

Veprimet kryesore në këtë drejtim, përfshijnë ofrimin e trainimeve dhe orientimit lidhur me Kodin e Sjelljes; komunikimin në mënyrë të përshtatshme të kërkesave të Kodit të Sjelljes ndaj personave të cilët punojnë me dhe për Federatën, ashtu si dhe ndaj atyre të cilët vihen në kontakt me Federatën siç mund të jenë fëmijët, të rinjtë, familjet, komunitetet dhe partnerët; ashtu si dhe të siguruarit që njerëzit të jenë të ndërgjegjshëm rreth asaj se si t'i raportojnë shqetësimet që kanë, në mënyrë të përshtatshme dhe të sigurtë për ta.

Këto veprime kryesore përfshijnë:

- Pajisjen e stafit dhe të personave të tjerë që punojnë me dhe për **SOS Fshatrat e Fëmijëve**, me rritje të ndërgjegjësimit, trainime dhe udhëheqjen, në lidhje me sjelljet e pritshme prej tyre dhe Kodin e Sjelljes. Kjo mund të nënkuptojë që, për disa antarë të stafit apo persona me role të caktuara, të kishte nevojë për udhëheqje specifike shtesë.
- Komunikimin e Kodit tonë të Sjelljes me fëmijët, të rinjtë, familjet, komunitetet dhe partnerët, ashtu si dhe ndaj të gjithë atyre të tjerëve të cilët vihen në kontakt me fëmijët dhe të rinjtë në kujdesin tonë, në mënyrë që ata të jenë të ndërgjegjshëm për pritshmëritë dhe të na ndihmojnë në procesin e llogaridhënies.
- Fuqizimin dhe rishikimin e vazhdueshëm të politikave dhe procedurave në mbështetje të implementimit të Kodit të Sjelljes, siç janë ato që kanë të bëjnë me manaxhimin e Burimeve Njerëzore dhe atë financiar.
- Sigurimin që secili/a ta njohë mënyrën se si të raportojë, ftojë dhe mirëpresë raportimet në lidhje me shkeljet e dyshuara apo konkrete të Kodit të Sjelljes. Të gjitha këto raportime, do të trajtohen me seriozitet dhe do t'u jepet përgjigje, ashtu si dhe do të ndërmerren veprimet në përputhje me procedurat tona. Kjo përfshin ofrimin e mënyrave të përshtatshme për stafin dhe personat e tjerë për t'i ngritur shqetësimet e tyre në mënyrë konfidenciale dhe të sigurtë, ashtu si dhe në mënyrë anonime në rast se ata do të zgjidhnin të vepronin kështu, dhe në lidhje me shkeljet e dyshuara apo konkrete të Kodit të Sjelljes.
- Mbrojtjen e stafit dhe personave e tjerë të cilët bëjnë raportime lidhur me shkeljen e Kodit të Sjelljes, nga hakmarrja apo dhe reagime të tjera të ngjashme. Edhe nëse shkelja e raportuar do të konsiderohet si e pambshtetur në prova, SOS Fshatrat e Fëmijëve nuk do të ndërmarrin asnjë veprim kundër personit i cili/ e cila kane bërë raportimin, me kusht që ai raportim të jetë bërë me qëllime të mira. Po kështu është fakt i njohur që raportimet false dhe keqdashëse, përbëjnë edhe ato një shkelje të Kodit të Sjelljes.
- Monitorimin e implementimit të Kodit të Sjelljes, duke përfshirë por pa u kufizuar, me verifikimin e nënshkrimit të Angazhimit ndaj Kodit të Sjelljes, trainimeve dhe orientimeve për të gjithë ata persona, veprimtaria e të cilëve mbulohet nga Kodi i Sjelljes, si dhe rishikimin e shkeljeve të raportuara të Kodit të Sjelljes si dhe tendencave.

## Kodi i Sjelljes

Ky Kod i Sjelljes përcakton sjelljet e pritshme, të cilat të gjithë personat që punojnë me dhe në emër të SOS Fshatrat e Fëmijëve, DUHET të angazhohen për t'i ndjekur.

## Parimet themelore (B)

Federata jone operon nëpërmjet shumë modeleve të ndryshme dhe nganjëherë të vështira, të cilat krijojnë shumë sfida. Për këtë arsye, përveç krijimit të vlerave tona, **parimet kryesore** të mëposhtme janë ngulitur në sjelljet e pritshme të pasqyruara në Kodin e Sjelljes. Në rastet kur mund të ekzistonte ndonjë dyshim nëse një veprim do të ishte i pranueshëm apo jo, duhet t'u referohemi parimeve kryesore të përmendura më poshtë:

- **MOS SHKAKTIMI I DËMEVE** në mënyrë që aktivitetet e SOS Fshatrat e Fëmijëve të mos krijojnë impakt negativ tek jetët e individëve, komuniteteve, stafit dhe vullnetarëve të cilët krijojnë kontakte me personat të cilët punojnë me dhe për SOS Fshatrat e Fëmijëve.
- **RESPEKTI** për të gjithë individët dhe për dinjitetin e tyre, duke përfshirë promovimin dhe mbështetjen e **TË GJITHA TË DREJTAVE** (duke përfshirë këtu të drejtat e njeriut dhe të drejtat e veçanta të fëmijëve), si dhe angazhimet ndërkombëtare të cilat kanë të bëjnë me aktivitetet tona.<sup>3</sup>
- Promovimi i **PËRFSHIRJES** dhe parandalimi i **diskriminimeve të çdo lloji**, duke përfshirë, por pa u kufizuar me diskriminimin bazuar tek gjinia dhe/ose shprehja gjinore, etnia, raca, feja apo besimi fetar, pa/aftësia, orientimi seksual, kasta, origjina kombëtare dhe/ose sociale, qoftë kjo e qëllimshme apo e pa-qëllimshme, influencimet si të shprehura hapur ose të nënkuptuara, me synimin për të krijuar mardhënie më të barabarta.
- Adresimi i **MARDHËNIEVE** të pa-barabarta të **PUSHTETIT**, të cilat mund të manifestohen në formën e abuzimit me pushtetin, ose dhe në forma të tjera të privilegjeve apo shtypjes bazuar tek mosha, gjinia, identiteti gjinor, orientimi seksual, pa/aftësia, raca, besimi fetar apo çdo karakteristikë tjetër, të cilat mund ta vendosnin një individ në një pozicion të dis-avantazhuar.
- Promovimi i barazisë **GJINORE** me qëllimin për të krijuar një mjedis pune përfshirës dhe të barabartë, nëpërmjet adresimit të influencimeve me natyrë gjinore si dhe diskriminimet në rekrutim, në aksesin tek trainimet dhe zhvillimi, aksesin tek avancimi në karrierë dhe ndarja e roleve në bazë gjinie.
- Vlerësimi i **DIFERENCAVE KULTURORE dhe DIVERSITETIT**, me synimin për të reflektuar realitetet dhe perspektivat e vendit ku punojmë, dhe në veçanti për të siguruar që mënyra në të cilën ne punojmë është përfshirëse dhe jo-diskriminuese, dhe si e tillë, nuk vazhdon të kontribuojë dhe promovojë mardhënie të pa-barabarta pushteti.
- **JO-DHUNA**, qoftë ajo fizike, seksuale, emocionale ose verbale, në të gjitha veprimet tona, duke përfshirë këtu edhe sjelljet e dëmshme në vëndin e punës, dhe që lidhen me kujdesin ndaj fëmijëve.
- Vëzhgimi dhe promovimi i **STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE dhe PRAKTIKAVE MË TË MIRA** nëpër të gjitha aktivitetet e punës, duke përfshirë të drejtat e njeriut dhe parimet humanitare, dhe plotësimi i kërkesave të **GJITHA LIGJEVE TË APLIKUESHME** si vendore/kombëtare ashtu dhe ndërkombëtare, duke aplikuar ndërkohë standardet më të larta në çdo moment kohor.
- Zbatimi i standardeve më të larta të **INTEGRITETIT- STANDARDEVE ETIKE dhe TË PROFESIONALIZMIT**.
- Angazhimi nëpërmjet punës tonë ndaj ekologjisë, mjedisit dhe biodiversitetit dhe ndarja e këtyre parimeve me fëmijët, të rinjtë dhe komunitetet. Kjo nënkupton realizimin e punës në mënyrë të QËNDRUESHME nga pikëpamja mjedisore, duke promovuar praktikën miqësore me mjedisin.

### Shkeljet e Kodit të Sjelljes- Raportimi i shqetësimeve dhe incidenteve

Kodi i Sjelljes i vë si detyrë të gjithë personave të cilët punojnë me ose për SOS Fshatrat e Fëmijëve, për të raportuar çdo shqetësim që ata mund të kenë, në lidhje me shkeljet e mundshme ose konkrete të Kodit të Sjelljes.

Çdo incident do të manaxhohet në përputhje me rregulloret për Raportimin dhe Reagimin si dhe politikat dhe procedurat e tjera të Burimeve Njerëzore. Nuk është e nevojshme të ekzistojnë prova apo evidenca, thjesht një shqetësim që Kodi i Sjelljes është shkelur, do të ishte i mjaftueshëm.

Një raportim mund të realizohet në mënyrë anonime duke përdorur kanalet e duhura të raportimit. Duke e mirëkuptuar dëshirën për të raportuar në mënyrë anonime, personat që raportojnë, janë të inkurajuar fuqimisht që t'i tregojnë detajet e tyre të kontaktit. Të gjitha këto detaje do të mbahen konfidenciale. Ofrimi i këtij informacioni do të kontribuojë për të siguruar që raporti do të ndiqet në vazhdimësi nëse do të ishte e nevojshme, në mënyrë që ai të mund të investigohej sa më gjërësisht.

Në rregulloret e Raportimit dhe Reagimit janë treguar dhe përshkruar mënyra të shumta të raportimit të shqetësimeve. Ato mund të adaptohen për t'iu përshtatur kontekstit specifik lokal. Për këtë arsye, personat që kanë një shqetësim, duhet të përdorin kanalet e identifikuara dhe të përcaktuara të raportimit në vendndodhjet e tyre. Përveç këtyre, raportet mund t'i drejtohen SOS Fshatrat e Fëmijëve, duke përdorur një adresë të dedikuar e-mail si dhe një numër telefoni (pa pagesë), të manaxhuara nga Ekipi i Manaxhimit të Incidenteve: [misconduct@sos-kd.org](mailto:misconduct@sos-kd.org) (të manaxhuar nga Zyra Ndërkombëtare (IO), dhe, për shembull, [misconduct-eucm@sos-kd.org](mailto:misconduct-eucm@sos-kd.org), [misconduct-wcna@sos-kd.org](mailto:misconduct-wcna@sos-kd.org), etj. (të manaxhuara nga Zyrat Ndërkombëtare Rajonale individuale). Raportet mund të realizohen gjithashtu edhe nëpërmjet kanaleve konfidenciale të "bilbil-fryrësve" (të disponueshëm [këtu](#) dhe [këtu](#).)

Me kusht që një raport të mos jetë keqdashës, asnjë veprim nuk do të ndërmerret kundër asnjë personi që realizon një raportim. Do të vihet në dispozicion edhe mbrojtje, aty ku kjo do të ishte e nevojshme, për të parandaluar çdo veprim hakmarrës kundër kujtdo që ka bërë një raportim me mirëbesim dhe qëllim të mirë, duke përfshirë këtu edhe ofrimin e mbështetjes shtesë, nëse kjo do të ishte e nevojshme.

## Pritshmëritë e sjelljes – nga individët dhe personat e tjere (B)

Kodi i Sjelljes DUHET të zbatohet në çdo moment kohor.

- Unë do t'i trajtoj gjithmonë me respekt dhe dinjitet personat me të cilat do të vihem në kontakt si rezultat i angazhimit tim me SOS Fshatrat e Fëmijëve, dhe do ta mbështes privatësinë e tyre. Kjo përfshin pjesën tjetër të stafit, fëmijët, të rinjtë dhe familjet e tyre, antarët e komunitetit si dhe përfaqësuesit e organizatave partnere, duke përfshirë këtu edhe furnitorët dhe kontraktorët.**

Konkretisht, por pa u kufizuar me këto, kjo do të nënkuptojë që:

- Une do të përdor sjellje empatike dhe jo të dhunshme, në kuadrin e veprimeve, gjuhës dhe xhesteve të mia.
- Une nuk do të "bullizoj" apo ngacmoj askënd, duke përfshirë këtu ngacmimet seksuale ose dhe "bullizimin" verbal.
- Une nuk do të hyj kurrë në mardhënie seksuale me një fëmijë apo person të rritur pjesëmarrës në program.
- Une nuk do të hyj pa leje në hapsirat private (dhomat e gjumit, etj), dhe nuk do të realizoj kujdes personal ndaj një fëmije i cili/ e cila do të ishte në gjendje ta kryente vetë atë.

- Une do t'i respektoj të drejtat bazë të të gjithëve, pavarësisht nga gjinia, mosha, aftësia, shëndeti, gjuha, etnia, rraca, ngjyra, besimi fetar, kasta, orientimi seksual, identiteti gjinor, origjina kombëtare apo sociale si dhe çfarëdolloj aspekti tjetër i identitetit apo i karakteristikave personale.** Unë e kuptoj që pozicioni im në gjirin e SOS Fshatrat e Fëmijëve dhe në përgjithësi në gjirin e shoqërisë, mund të më pajisë me një pushtet të tillë i cili mund t'i kufizonte personat e tjerë për të mos u dakordësuar me mua apo për t'u shprehur lirshëm.

Konkretisht, por pa u kufizuar me këto, kjo do të nënkuptojë që:

- Unë do ta njoh dhe kuptoj gjithmonë faktin që pushteti im përbën një problem dhe në mënyrë aktive do të përpiqem që ta kufizoj impaktin e këtij pushteti ndaj të tjerëve.
- Unë do t'i fuqizoj dhe mundësoj të tjerët që të marrin pjesë, nëpërmjet promovimit të barazisë, përfshirjes dhe diversitetit.
- Unë do të përpiqem ta kuptoj paragjykimin tim.
- Unë nuk do të përfshihem kurrë në mardhënie shfrytëzuese seksuale/ martesë me askënd prej personave të cilët janë apo kanë qënë pjesëmarrës në programet e SOS Fshatrat e Fëmijëve, qofshin këta edhe antarë të komunitetit, duke përfshirë edhe personat e rritur të cilët janë përkujdesur nga SOS si fëmijë.

- Une do të veproj në mënyrë të drejtë, të ndershme dhe me takt, si dhe pa favorizim apo diskriminim. Kjo përfshin pjesën tjetër të stafit, fëmijët, të rinjtë dhe familjet e tyre, antarët e**

**komunitetit si dhe përfaqësuesit e organizatave partnere, duke përfshirë ketu edhe furnitorët dhe kontraktorët.**

Konkretisht, por pa u kufizuar me këto, kjo do të nënkuptojë që:

- Unë do të krijoj dhe mbaj gjithmonë kufinj të qartë dhe të përshtatshëm profesionalë, gjatë mardhënieve të mia me sponsorët, ofruesit e shërbimeve, kontraktorët, kolegët, fëmijët dhe të rinjtë e komunitetit ku unë shërbej.
- Unë do të deklaroj dhe zbuloj çdo konflikt interesi, duke përfshirë edhe paragjykimet e mundshme dhe mardhënien në lidhje me një pjesëtar të farefisit ose mik, si dhe do ta largoj veten time nga çdo lloj procesi vendim-marrës, duke përfshirë këtu edhe veprimet në lidhje me rekrutimin.
- Unë nuk do të punësoj antarë të stafit të cilët janë farefis apo miq të personave të cilët punojnë për SOS Fshatrat e Fëmijëve, përveç se kur do të demonstrohej nëpërmjet praktikave të qarta të rekrutimit, që ata do të ishin personat më të përshtatshëm për atë punë të caktuar. Une nuk do të punësoj asnjë antar të farefisit të afërt apo me lidhje gjaku.<sup>4</sup>

**4. Une do të siguroj që fëmijët dhe të rinjtë në përkujdesjen apo në kontakt me SOS Fshatrat e Fëmijëve, të mbahen të sigurtë dhe që do të ndërmerren të gjitha masat për të parandaluar që ata të dëmtohen, abuzohen apo keqtrajtohen në çfarëdo mënyre.**

Konkretisht, por pa u kufizuar me këto, kjo do të nënkuptojë që:

- Unë nuk do të përdor ndëshkime fizike/dënime trupore për t'i disiplinuar fëmijët.
- Unë do të siguroj që fëmijët nën përkujdesjen time të jenë gjithmonë të mbikqyruar siç duhet nga persona të rritur të përshtatshëm.
- Në të gjitha veprimet e mia, unë do ta vendos gjithmonë si konsideratën time parësore interesin më të mirë të fëmijëve.

**5. Unë do t'i respektoj ligjet kombëtare si dhe kulturën, traditat, zakonet dhe praktikat lokale, ashtu si dhe traktatet e Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut si dhe instrumentat e tjerë të të drejtave të njeriut, dhe politikat dhe procedurat e SOS Fshatrat e Fëmijëve, përveç rasteve kur duke vepruar kështu, do t'i shkaktoja dëme personave të tjerë. Në raste të tilla unë do të lajmëroj menjëherë manaxherin tim të linjës, supervizorin/en apo Burimet Njerëzore.**

**6. Konkretisht, por pa u kufizuar me këto, kjo do të nënkuptojë që:**

- Pavarësisht nga mosha e pëlqimit/e pjekurisë në vënd, unë gjithmonë do ta konsideroj një fëmijë si këdo fëmijë tjetër nën moshën 18 vjeçare.
- Përveç raportimit në kuadrin e kërkesave të Kodit të Sjelljes, aty ku nevojitet në kuadrin e legjislacionit kombëtar, unë do t'i raportoj tek autoritetet përkatëse të gjitha rastet e abuzimit dhe dëmtimit, apo dhe veprimet kriminale.

**7. Unë e njoh dhe kuptoj faktin që reputacioni i SOS Fshatrat e Fëmijëve ka rëndësi parësore, por në të njëjtën kohë, unë e kuptoj gjithashtu edhe faktin që ruajtja duhet të përbëjë gjithmonë prioritet dhe që shqetësimet e ruajtjes duhet të raportohen edhe nëse ky raportim në aparcencë do të dukej sikur do ta dëmtonte reputacionin e Federatës.**

Konkretisht, por pa u kufizuar me këto, kjo do të nënkuptojë që:

- Në çdo situatë kur unë besoj që Kodi i Sjelljes mund të jetë shkelur, unë do t'i raportoj menjëherë shqetësimet e mia duke përdorur kanalet e duhura, duke përfshirë nese do të ishte e nevojshme edhe agjensitë kombëtare.
- Në çdo situatë emergjence, unë do të ndërmarr veprimet e menjëherëshme të nevojshme me qëllimin për të siguruar ruajtjen dhe mirëqënien e të tjerëve, në përputhje me parimet themelore dhe frymën e Kodit të Sjelljes.
- Unë do të sfidoj (dhe raportoj në kuadrin e Kodit të Sjelljes nëse do të ishte e nevojshme), çdo formë të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë të diskriminimit, duke përfshirë këtu pabarazinë gjinore, ngacmimet, apo abuzimet (fizike, seksuale apo verbale), frikësimin apo shfrytëzimin, apo dhe çfarëdo lloj veprimi tjetër i cili do të shkelte të drejtat e të tjerëve.

8. **Unë e kuptoj dhe njoh faktin që jam një përfaqësues i SOS Fshatrat e Fëmijëve dhe që në sjelljen time si dhe gjatë ndërveprimit tim me partnerët, fëmijët, të rinjtë dhe familjet, agjensitë e tjera dhe në gjirin e organizatës, une do të përpiqem që gjithmonë të demonstroj vlerat e organizatës, si dhe do të përpiqem që të sillem gjithmonë në një mënyrë e cila nuk e ve në diskutim besimin dhe besueshmërinë tek SOS Fshatrat e Fëmijëve.**

Konkretisht, por pa u kufizuar me këto, kjo do të nënkuptojë që:

- Unë do ta zbatoj në çdo kohë Kodin e Sjelljes.
  - Unë do të punoj në emër të SOS Fshatrat e Fëmijëve dhe nuk do të angazhohem në aktivitete të tjera të cilat mund të jenë në konflikt apo në konkurrencë – për shembull duke u angazhuar në një punësim tjetër, përveç rasteve kur leja për ta bërë këtë, do të jepej nga manaxheri im i Burimeve Njerëzore.
  - Unë nuk do të pranoj asnjë favor personal, dhurata, grante, kontribute, donacione, apo çfarëdolloj shpërblimi tjetër material, i cili të lidhet me statusin apo funksionin tim në kuadrin e SOS Fshatrat e Fëmijëve.
  - Unë nuk do t'i përdor burimet e SOS Fshatrat e Fëmijëve për ndonjë qëllim tjetër të ndryshëm nga qëllimi për të cilin ato janë ideuar, apo dhe për përfitime personale.
  - Unë nuk do të paguaj, me para në dorë apo në natyrë, për çfarëdolloj shërbimi seksual, për sa kohë do të jem në detyrë apo duke përfaqësuar SOS Fshatrat e Fëmijëve.
9. **Unë do të siguroj që ruajtja do të jetë konsiderata primare dhe do t'i paraprijë çdo veprimi që unë do të kryej.**

Konkretisht, por pa u kufizuar me këto, kjo do të nënkuptojë që:

- Unë do t'i administroj burimet që më janë besuar nga SOS Fshatrat e Fëmijëve, në mënyrë transparente dhe të përshtatshme, si dhe përputhje me procedurat e përcaktuara të cilat sigurojnë përdorimin optimal të të gjitha materialeve dhe burimeve njerëzore.
  - Unë do t'i përdor kompjuterat si dhe pjesët e tjera të teknologjisë së informacionit vetëm në mënyrë të përgjegjshme dhe në përputhje të plotë me ligjet, procedurat, rregulloret dhe rregullat përkatëse që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të dhënave dhe sigurinë e Teknologjisë së Informacionit, si dhe nuk do të angazhohem në përdorimin e papërshtatshëm të tyre, veçanërisht në lidhje me krijimin, shikimin, shkarkimin apo shpërndarjen e çdo materiali të papërshtatshëm apo ofensiv, duke përfshirë këtu, por pa u kufizuar, me imazhet abuzive apo me karakter shfrytëzues të fëmijëve, materialet seksuale të fëmijëve për qëllime shfrytëzimi (ajo që më parë njihet me termin “pornografia fëmijërore” ose pornografia në përgjithësi).
  - Në rastet kur do të jem përgjegjës për punën e të tjerëve, për shembull në rastet e furnitorëve, shitësave apo kontraktorëve, unë do të siguroj që ato do të jenë të supervizuara siç duhet dhe të përputhen me sjelljet e pritshme nga Kodi i Sjelljes.
10. **Unë do të ruaj konfidencialitetin dhe do ta ndaj informacionin me të tjerët vetëm në bazë të parimit “ata-që-duhet-të-dinë”, në përputhje me procedurat, rregulloret dhe rregullat e privatësisë së të dhënave dhe mbrojtjes së të dhënave.**

Konkretisht, por pa u kufizuar me këto, kjo do të nënkuptojë që:

- Unë do t'u përmbahem të gjitha ligjeve, rregullave dhe rregulloreve që lidhen me mbrojtjen e të dhënave si dhe do të kërkoj udhëzime në rast se nuk do të isha i/e sigurtë se si të aplikoheshin ato.
  - Unë do të postoj imazhe dhe informacione rreth individëve në kontekstin e SOS Fshatrat e Fëmijëve nëpër platformat profesionale (për shembull jo në faqet personale të Facebook), vetëm duke respektuar kufizimet që vijnë si rezultat i fushës së veprimtarisë së pëlqimit të dhënë në këto raste.
  - Unë do të siguroj që lejet përkatëse të jenë marrë gjithmonë qysh më përpara, dhe që çdo informacion, imazh, etj, të mos jetë shfrytëzues apo poshtëruar.
  - Unë nuk do të komunikoj asnjë informacion të ndjeshëm apo potencialisht dëmtesues, tek organizma apo individë të jashtëm, duke përfshirë këtu edhe përfaqësuesit e mediave, pa patur autorizimin e duhur për këtë.
11. **Unë e njoh dhe kuptoj faktin që në kuadrin e vëndit të punës dhe vendodhjeve tona, ne përballemi në mënyrë të vazhdueshme me rrethana dhe sfida të reja, dhe unë angazhohem në emër të aftësive të mia më të mira, për t'i kapërcyer këto sfida nëpërmjet të menduarit fleksibël dhe strategjik, si dhe nëpërmjet të punuarit bashkëpunues me personat e tjerë të tillë si kolegët, partnerët, furnitorët,**

## **kontraktorët dhe antarët e komunitetit (duke përfshirë fëmijët dhe të rinjtë).**

Konkretisht, por pa u kufizuar me këto, kjo do të nënkuptojë që:

- Unë do të inicioj në mënyrë aktive dialogë dhe shkëmbime të hapura kurdoherë që të kem mundësi, dhe do të mbështes dhe kontriboj në përpjekjet e të tjerëve, nëse kjo do të ishte e nevojshme. Kjo përfshin edhe bashkëpunimin me kolegët e mi përgjatë fushave dhe kulturës funksionale.
- Unë do t'i vlerësoj dhe respektoj perspektivat, zgjedhjet dhe pikëpamjet e të tjerëve, edhe në rast se nuk do të isha dakord me to. Megjithatë, në rast se këto perspektiva, zgjedhje dhe këndvështrime do të binin ndesh me përcaktimet e këtij Kodi të Sjelljes, une do t'i raportoj ato tek manaxheri im i linjës, supervizori/ja apo tek Burimet Njerëzore.
- Unë do ta respektoj fushën e kompetencës së secilit dhe do të përpiqem të promovoj dhe fuqizoj punën ndër-disiplinare, gjithmonë në të mirë dhe përfitim të fëmijëve, të rinjve dhe familjeve.

## **12. Në rast se roli im do të ishte ai i manaxherit apo liderit, unë e kuptoj faktin që do të kisha përgjegjësi të tjera shtesë, për të krijuar modelin e sjelljes së mirë të promovuar nëpërmjet këtij Kodi të Sjelljes, me qëllimin për të krijuar një mjedis në të cilin sjellja e mirë të mund të "lulëzojë".**

Konkretisht, por pa u kufizuar me këto, kjo do të nënkuptojë që:

- Unë do të siguroj që bashkë-punonjësit dhe personat e asociuar me SOS Fshatrat e Fëmijëve, të jenë të ndërgjegjësuar rreth Kodit të Sjelljes si dhe të jenë të mbështetur në vënien në praktikë të tij.
- Unë do të demonstroj leadership në promovimin e përfshirjes dhe ndarjes së barabartë të pushtetit dhe vendim-marrjes nga burrat dhe gratë bashkë-punonjës si dhe nga persona të tjerë të cilët tradicionalisht mund të mos kenë mundësi për t'u shprehur apo të cilët mund të jenë të marginalizuar.
- Në rast se unë do të jem në një pozicion leadership-i, unë do të veproj në përputhje me misionin, vizionin dhe strategjinë e SOS Fshatrat e Fëmijëve, si dhe do t'ia komunikoj ekipit tim vlerat dhe misionin e Federatës dhe do të marr vendime të cilat të jenë konsistente.
- Unë e njoh dhe kuptoj faktin që përfshirja në një mardhënie intime me bashkë-punonjës, mund të çojë në një konflikt interesi, gjë e cila duhet shmangur. Për të siguruar ekzistencën e një mjedisi profesional, unë do të punoj në mënyrë konstruktive me organizatën, për të gjetur një zgjidhje të drejtë dhe jo-diskriminuese për personat e përfshirë.

## **13. Unë do t'i realizoj përgjegjësitë e mia me standardet më të larta të profesionalizmit, duke zbatuar kompetencat dhe aftësitë e mia më të mira, dhe do të jem i ndershëm me veten time dhe të tjerët në lidhje me atë që bëj, duke njohur dhe kuptuar aftësitë dhe kufizimet e mia.**

Konkretisht, por pa u kufizuar me këto, kjo do të nënkuptojë që:

- Unë do të kërkoj mundësi për të mësuar, duke përfshirë ndjekjen e trainimeve ashtu siç kërkohet, si dhe do të kërkoj sqarime, duke përfshirë këtu edhe rastet kur mund të jem i paqartë rreth mënyrës se si aplikohet Kodi i Sjelljes në mjedisin tim të punës.
- Unë do të përpiqem në mënyrë aktive që të kuptoj dhe ndjek trainimet për të mësuar rreth paragjyqimeve të mia individuale, si dhe për ta përmirësuar praktikën time në mënyrë që të veproj pa diskriminuar asnjë person.
- Unë do të kërkoj mbështetje nga manaxheri/supervizori apo nga Burimet Njerëzore, në rast se do të ndihesha jo në gjëndje për t'i realizuar siç duhet detyrat/rolin tim, për çfarëdolloj arsye, si dhe do të kërkoj ndihmë në rast se do të kem nevojë për të, me qëllim që të ruaj mirëqënien dhe aftësinë time për të punuar efektivisht.
- Unë do të siguroj që aftësia për të realizuar punën time, nuk do të pengohet nga sjellja ime, për shembull duke mos lejuar që të punoj nën influencën e substancave toksike të tilla si alkooli apo ilaçeve të tjera të pa-këshilluara nga mjeku.
- Unë do të mbaj gjithmonë përgjegjësi për veprimet dhe mangësitë e mia.

**Unë e pranoj që më është dhënë një kopje e Kodit dhe që e kam lexuar atë.**

# Angazhimi ndaj Kodit të Sjelljes(B)

Nëpërmjet nënshkrimit të këtij dokumenti, une e pranoj që më është dhënë një kopje e Kodit të Sjelljes dhe që jap angazhimin tim për t'iu përmbajtur kërkesave të Kodit të Sjelljes.

Unë do t'iu përmbahem vlerave, parimeve dhe kompetencave të kërkuara në Kodin e Sjelljes dhe do t'iu plotësoj kërkesat e tij duke vepruar në çdo kohë sipas interesave më të mira të Federatës dhe fëmijëve dhe të rinjve nën përkujdesjen e saj, të personave të rritur pjesëmarrës në programe, antarëve të komunitetit si dhe të gjithë atyre të cilët punojnë me ose në emër të SOS Fshatrat e Fëmijëve.

Unë e pranoj që mund të ndodhin situata të cilat nuk janë të parashikuara nga Kodi i Sjelljes, dhe që në këto raste do të punoj duke zbatuar frymën e Kodit të Sjelljes si dhe duke mbështetur vlerat dhe parimet e SOS Fshatrat e Fëmijëve të cilat përbëjnë shtyllat themelore të Kodit të Sjelljes.

Une e kuptoj faktin që pavarësisht se SOS Fshatrat e Fëmijëve ofrojnë trainime dhe orientime me qëllim të kuptuarit sa më mirë të Kodit të Sjelljes, unë kam një përgjegjësi personale për ta lexuar dhe kuptuar Kodin e Sjelljes si dhe për të kërkuar udhëheqje të mëtejshme nga manaxheri im i linjës/supervizori apo Burimet Njerëzore, në rast se do të jem i paqartë në çdo kohë në lidhje me mënyrën se si do të aplikoheshin përcaktimet e Kodit të Sjelljes.

Unë e kuptoj dhe pranoj që ndaj çdo shkeljeje të Kodit të Sjelljes, do të kishte reagim në përputhje me politikën, udhëzuesit dhe praktikën më të mira të SOS Fshatrat e Fëmijëve, ashtu si dhe me ligjet kombëtare. Në varësi të shkallës së seriozitetit të shkeljes, SOS Fshatrat e Fëmijëve mund të iniciojnë veprime administrative të cilat mund të përfshijnë trainime dhe udhëheqje të mëtejshme, paralajmërime verbale apo me shkrim; akte disiplinore të cilat mund të përfshijnë pezullimin dhe në rastet serioze edhe përfundimin e punësimit/angazhimit; dhe/ose referimin tek agjensitë ligj-zbatuese në rastet kur shkeljet e dyshuara do të përfshinin akte kriminale.

Unë konfirmoj që e kam lexuar dhe kuptuar Kodin e Sjelljes dhe e kuptoj që një kopje e saj me nënshkrimin tim do të ruhet në dosjen time.

Emri:

Nënshkrimi:

Data: